

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi

RAPORTI VJETOR 2022-2023

**Nga trashëgimia te
inagurimi: Festojmë 30
vjet në Shqipëri dhe
vitin e parë të
shërbimit në Mal të Zi**



Përmbajtja:

- Mesazh nga i Ngarkuari me punë i SHBA-së në Shqipëri
- Mesazh nga Ambasadorja e SHBA-së në Mal të Zi
- Fjala përshëndetëse e Drejtoreshës për Shqipërinë dhe Malin e Zi
- Misioni i Korpusit të Paqes
- Korpusi i Paqes në Shqipëri
- Korpusi i Paqes në Mal të Zi
- Kthimi historik i Vullnetarëve në vitin 2022 dhe i grupi i ri i vitit 2023
 - *Prezantimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi*
 - *Vullnetarët mobilizojnë fuqinë e të rinjve duke krijuar udhëheqës të së nesërme*
 - *Trajnimi i Vullnetarëve dhe të nxëniet e vazhduar*
- Vështrim i përgjithshëm i projekteve
- Objektivat sipas sektorit
 - *Zhvillimi organizativ*
 - *Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve*
 - *Mësimdhënia e gjuhës angleze në Shqipëri*
 - *Mësimdhënia e gjuhës angleze në Mal të Zi*

Përmbajtja:

- Transmetimi i kulturës dhe traditave amerikane
- Transmetimi i kulturës shqiptare dhe malazeze
- Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar
 - *Shërbimi virtual në Shqipëri dhe Mal të Zi*
 - *Mbështetja e rekrutimit të Vullnetarëve*
 - *Komiteti i Përmirësimit të Shërbimit*
 - *Rrjeti i Mbështetjes nga Kolegët*
 - *Grupi i Punës për Komunikimet*
- Mbështetja administrative efektive e operacioneve të Korpusit të Paqes
- Shërbimet mjekësore gjithëpërfshirëse për Vullnetarët
- Siguria dhe sigurimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes
- Stafi ynë i përhershëm gjatë periudhës 2022-2023
- Partnerët tanë - Çelësi i ndikimit tonë

Të dashur miq,

Dua t'u shpreh falënderimet e mia të përzemërta Vullnetarëve të Korpusi të Paqes, agjencie, familjeve dhe komuniteteve pritëse në Shqipëri për punën altruiste prej më shumë se 30 vjetësh.

Teksa lëmë pas pandeminë globale, qëndrueshmëria, përkushtimi dhe përshtatshmëria e treguar nga Vullnetarët e Korpunit të Paqes dhe komunitetet e tyre më ka lënë shumë mbresa. Angazhimi i tyre për nxitjen e mirëkuptimit ndërkulturor dhe promovimin e arsimit jo vetëm që ka pasuruar jetët e nxënësve, mësuesve dhe komuniteteve shqiptare, por edhe ka fuqizuar lidhjen e qëndrueshme mes dy vendeve tona. Vullnetarët e Korpunit të Paqes kanë pasur role të rëndësishme si mësues të gjuhës angleze, edukues në shkollë për shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve dhe ekspertë të zhvillimit organizativ me partnerë shqiptarë të qeverisjes vendore dhe të shoqërisë civile. Kontributet e tyre të shumta kanë lënë ndikim afatgjatë në kontekstin arsimor, shëndetësor dhe organizativ në Shqipëri.

Rezultatet frymëzuese të bashkëpunimit mes Vullnetarëve tanë dhe partnerëve, nxënësve e komuniteteve shqiptare nxjerrin në pah frymën e paqes, miqësisë dhe bashkëpunimit, që qëndron në thelb të misionit të Korpunit të Paqes. Përkushtimi dhe ngrohtësia e treguar nga homologët shqiptarë të Korpunit të Paqes vlerësohen thellësisht. Angazhimi i tyre për idealet e paqes, mirëkuptimit dhe shkëmbimit kulturor ka luajtur rol të rëndësishëm për krijimin e një mjedisi ku mund të lulëzojë fuqia e vërtetë e bashkëpunimit mes njerëzve.

Mesazh nga i ngarkuari me punë i SHBA-së në Shqipëri David Wisner



 *Ambassador of the United States of America*
Tirana, Albania
January 23, 2024

Dear Friends,

I extend my heartfelt thanks for the over 30 years of selfless effort by Peace Corps Volunteers, host agencies, host families, and host communities in Albania.

As we turn the page on the global pandemic, I am deeply impressed by the resilience, dedication, and adaptability demonstrated by the Peace Corps Volunteers and their communities. Their commitment to fostering cross-cultural understanding and promoting education has not only enriched the lives of Albanian students, teachers, and communities but has also strengthened the ties of friendship between our two nations. The Peace Corps Volunteers have played a vital role in Albanian development, and we have shared the enduring bond of friendship and mutual respect. The Peace Corps Volunteers have played a vital role in Albanian development, and we have shared the enduring bond of friendship and mutual respect. The Peace Corps Volunteers have played a vital role in Albanian development, and we have shared the enduring bond of friendship and mutual respect.

The inspiring results of the cooperation between our Volunteers and Albanian partners, students, and communities underscore the spirit of peace, friendship, and collaboration that lies at the heart of the Peace Corps mission. We are profoundly grateful for the commitment, dedication, and warm hospitality of our Albanian counterparts. Your generosity is a shining example of the goodness that exists between the Albanian people and the Peace Corps community.

Mesazh nga i ngarkuari me punë i SHBA-së në Shqipëri David Wisner

Një mirënjohje e veçantë shkon edhe për familjet pritëse shqiptare, që me kënaqësi kanë hapur dyert e tyre për Vullnetarët tanë. Falë mikpritjes dhe mbështetjes suaj jo vetëm që keni ofruar një shtëpi të dytë, por keni hedhur bazat për lidhje afatgjata mes kulturave tona. Bujaria juaj është një shembull i shkëlqyer i vullnetit të mirë që egziston ndërmjet popullit shqiptar dhe komunitetit të Korpusit të Paqes.

Dua të ndaj vlerësimet më të sinqerta për Vullnetarët tanë të Korpusit të Paqes. Angazhimi juaj për të ndarë pasurinë e kulturës së SHBA-së, si dhe zelli juaj i padiskutueshëm për të mësuar rreth kulturës shqiptare dhe për ta përqaftuar atë kanë lënë gjurmë te kushdo që ju kanë takuar.

Dua të shpreh urimet e mia të përzemërta për të gjithë ata që kanë bërë të mundur suksesin e jashtëzakonshëm të programit të Korpusit të Paqes në Shqipëri. Mezi pres të jem dëshmitar i ndikimit dhe rritjes së vazhdueshme të Korpusit të Paqes këtu, dhe ju falënderoj për përkushtimin tuaj ndaj idealeve të paqes, miqësisë, mirëkuptimit dhe shkëmbimit kulturor.

Sinqerisht,

David G. Wisner



Të dashur miq, partnerë dhe kolegë,

Jam shumë e kënaqur teksa reflektoj mbi arritjet dhe sukseset e vitit të shkuar, veçanërisht për faktin që shënon vitin e parë që Korpusi i Paqes i Shteteve të Bashkuara ka mirëpritur shtetas amerikanë si Vullnetarë për të shërbyer në Mal të Zi. Për më tepër, është një vit me rëndësi të madhe duke qenë se Vullnetarët u kthyen në Mal të Zi pas pandemisë globale.

Si Ambasadore e Shteteve të Bashkuara për Malin e Zi, kam pasur nderin të dëshmoj ndikimin pozitiv të Vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe homologëve të tyre gjatë vitit të parë të shërbimit përmes mësimdhënies së përbashkët të gjuhës angleze në Mal të Zi. Përkushtimi dhe angazhimi i tyre gjatë këtij viti inaugurues kanë spikatur. Puna e tyre ka kontribuar në kontekstin arsimor në Mal të Zi dhe ka forcuar lidhjet mes dy vendeve tona. Mësimdhënia e gjuhës angleze në shkollat malazeze është nismë thelbësore, e cila shkon përtej transferimit të aftësive gjuhësore. Ajo është një urë që lidh kulturat tona duke nxitur mirëkuptimin dhe vlerësimin e përbashkët. Përkushtimi i palëkundur i vullnetarëve tanë për të shërbyer është dëshmi e partneritetit mes SHBA-së dhe Malit të Zi.

Vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe homologët e tyre, kanë transferuar me përlulësi dhe pasion aftësitë thelbësore të nxënësit. Shkëmbimi i dijeve ka qenë i dyanshëm dhe Vullnetarët tanë kanë marrë njohuri kulturore të vlefshme. Shkëmbimi reciprok kulturor jo vetëm që u ka zgjeruar perspektivat, por ka shërbyer si një urë tjetër. Këtë herë për të lidhur zemrat dhe mendjet e amerikanëve dhe malazezëve, duke lënë gjurmë si në jetët e Vullnetarëve ashtu edhe të komuniteteve ku ata shërbejnë. Dua t'u shpreh mirënjohjen time Vullnetarëve të Korpusit të Paqes për përkushtimin, qëndrueshmërinë dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj kulturave. Gjithashtu, dua të ndaj vlerësimin tim për stafin e Korpusit të Paqes dhe homologët e tyre në Ministrinë e Arsimit lidhur me përpjekjet e tyre të palodhura për këshillimin dhe orientimin e Vullnetarëve dhe komuniteteve të tyre gjatë kësaj përvoje transformuese.

Mesazh nga ambasadorja e SHBA-së në Mal të Zi, Judy Rising Reinke



Dear Friends, Partners, and Colleagues,

It is with great pleasure that I reflect on the achievements and successes of the past year, particularly considering it marks the first year since that the United States Peace Corps has national American citizens as volunteers to serve across Montenegro. Furthermore, it is a moment of immense significance as the volunteers related to Montenegro following the global pandemic.

As the United States Ambassador to Montenegro, I am honored to witness the positive impact of the Peace Corps Volunteers and their counterparts during their first year of service in this beautiful year. The exchange of knowledge between them has been remarkable, and the dedication and commitment demonstrated during this time has been truly inspiring. Their efforts have contributed to the educational landscape of Montenegro and enriched the communities they serve. The reciprocal relationship between the volunteers and the communities they serve is a testament to the power of mutual understanding and respect.

It is a bridge that connects two cultures, one that gives them the opportunity to learn from the United States and Montenegro, and another that gives them the opportunity to share their own experiences and perspectives with the United States and Montenegro.

With humility and passion, the Peace Corps Volunteers and their counterparts have been instrumental in building a stronger relationship between the two countries. They have been instrumental in building a stronger relationship between the two countries. They have been instrumental in building a stronger relationship between the two countries. They have been instrumental in building a stronger relationship between the two countries.

The partnership between Americans and Montenegrins, as exemplified by the Peace Corps Volunteers, is a testament to the power of mutual understanding and respect. It is a bridge that connects two cultures, one that gives them the opportunity to learn from the United States and Montenegro, and another that gives them the opportunity to share their own experiences and perspectives with the United States and Montenegro.

This year marked the beginning of a new chapter for the Peace Corps in Montenegro, and I am excited that it is a testament to the power of mutual understanding and respect. It is a bridge that connects two cultures, one that gives them the opportunity to learn from the United States and Montenegro, and another that gives them the opportunity to share their own experiences and perspectives with the United States and Montenegro.

I look forward to the future and the many more opportunities that will come. I am excited that it is a testament to the power of mutual understanding and respect. It is a bridge that connects two cultures, one that gives them the opportunity to learn from the United States and Montenegro, and another that gives them the opportunity to share their own experiences and perspectives with the United States and Montenegro.

Judy Rising Reinke

Për më tepër, dua të shpreh vlerësimet më të mira për komunitetet dhe familjet pritëse që kanë mirëpritur përzemërsisht Vullnetarët tanë në shtëpitë e tyre. Bujaria dhe mikpritja juaj kanë luajtur rol të rëndësishëm për krijimin e një mjedisi mbështetës për zhvillimin e Vullnetarëve, duke u mundësuar një integrim të suksesshëm në komunitetet malazeze.

Partneriteti mes amerikanëve dhe malazezëve, siç tregohet nga Vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe mësuesit e tyre kolegë, shkollat dhe familjet pritëse, është vërtetë frymëzues. Ai është një shembull i shkëlqyer i asaj që mund të arrihet kur njerëz me prejardhje të ndryshme bashkohen për një qëllim dhe zotim të përbashkët për të ndikuar pozitivisht te paqja dhe miqësia në botë.

Ky vit shënoi fillimin e një kapitulli të ri për Korpusin e Paqes në Mal të Zi dhe hodhi hapat e parë për bashkëpunime dhe suksese në të ardhmen. Jam e emocionuar që një grup i ri Vullnetarësh do të zotohen për të filluar shërbimin shumë shpejt në shumë komunitete të tjera në Mal të Zi. Lidhjet e krijuara dhe mësimet e nxjerra gjatë këtij viti inaugurues do të hapin padyshim rrugën për partneritete më me ndikim, më të qëndrueshme dhe reciprokisht më të dobishme në vitet në vijim.

Me respekt,

Judy Rising Reinke

Mesazh nga ambasadorja e SHBA-së në Mal të Zi, Judy Rising Reinke



Dear Friends, Partners, and Colleagues,

It is with great pleasure that I report on the achievements and successes of the past year, particularly considering it marks the first year since the United States' Peace Corps has welcomed American citizens as volunteers to serve in Montenegro. Furthermore, it is a year of immense significance as the volunteers returned.

As the United States Ambassador to Montenegro, I am honored to witness the positive impact of the Peace Corps volunteers and their communities. The exchange of knowledge, skills, and experiences across cultures and generations has contributed to the mutual understanding and respect between our two nations. The volunteers have brought with them a wealth of knowledge, skills, and experiences that have enriched the lives of the people of Montenegro. Their efforts and commitment to service are a testament to the partnership between the United States and Montenegro.

With friendship and goodwill, the Peace Corps volunteers and their communities have fostered a new understanding and respect between our two nations. The exchange of knowledge, skills, and experiences across cultures and generations has contributed to the mutual understanding and respect between our two nations. The volunteers have brought with them a wealth of knowledge, skills, and experiences that have enriched the lives of the people of Montenegro. Their efforts and commitment to service are a testament to the partnership between the United States and Montenegro.

I am proud to have been a part of this journey and to have seen the positive impact of the Peace Corps volunteers and their communities. The exchange of knowledge, skills, and experiences across cultures and generations has contributed to the mutual understanding and respect between our two nations. The volunteers have brought with them a wealth of knowledge, skills, and experiences that have enriched the lives of the people of Montenegro. Their efforts and commitment to service are a testament to the partnership between the United States and Montenegro.

The partnership between the United States and Montenegro is a testament to the mutual understanding and respect between our two nations. The exchange of knowledge, skills, and experiences across cultures and generations has contributed to the mutual understanding and respect between our two nations. The volunteers have brought with them a wealth of knowledge, skills, and experiences that have enriched the lives of the people of Montenegro. Their efforts and commitment to service are a testament to the partnership between the United States and Montenegro.

This year marked the beginning of a new chapter in the partnership between the United States and Montenegro. The exchange of knowledge, skills, and experiences across cultures and generations has contributed to the mutual understanding and respect between our two nations. The volunteers have brought with them a wealth of knowledge, skills, and experiences that have enriched the lives of the people of Montenegro. Their efforts and commitment to service are a testament to the partnership between the United States and Montenegro.

I am proud to have been a part of this journey and to have seen the positive impact of the Peace Corps volunteers and their communities. The exchange of knowledge, skills, and experiences across cultures and generations has contributed to the mutual understanding and respect between our two nations. The volunteers have brought with them a wealth of knowledge, skills, and experiences that have enriched the lives of the people of Montenegro. Their efforts and commitment to service are a testament to the partnership between the United States and Montenegro.

Judy Rising Reinke

Mesazh nga Drejtoresha për Shqipërinë dhe Malin e Zi, Megan Wilson

Të dashur miq të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi,

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj raportin e Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi për vitin 2022-2023. Raporti i këtij viti trajton një gamë të gjerë temash duke filluar nga kthimi i Vullnetarëve deri te prezantimi i grupeve të reja Vullnetare, projektet mbresëlënëse në katër sektorët tanë, modelet novatore të shërbimit dhe përvojat e ndara mes Vullnetarëve tanë dhe komuniteteve ku ata shërbejnë.

Teksa reflektojmë mbi arritjet, sfidat dhe përkushtimin e palëkundur të Vullnetarëve tanë të Korpusit të Paqes dhe të partnerëve vendas, kuptoj se ka qenë një periudhë e jashtëzakonshme. Mendoj se kthimi i Vullnetarëve tanë në shtator të vitit 2022 është një arritje thelbësore, duke marrë parasysh evakuimin e shkaktuar nga pandemia. Qëndrueshmëria dhe angazhimi i treguar nga VKP-të (Vullnetarët e Korpusit të Paqes) dhe komunitetet e tyre gjatë kësaj periudhe kanë qenë tejet frymëzuese. Nisur nga kjo arritje, në tetor të vitit 2023 mirëpritëm një grup të ri, duke fuqizuar ndjenjën e shërbimit, që përkufizon Korpusin e Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi.



Drejtorja e Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi për Vendin, Megan Wilson, dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Evis Kushi, në vitin 2022

Mesazh nga Drejtoresha për Shqipërinë dhe Malin e Zi, Megan Wilson

Në dhjetor të vitit 2023, mbyllëm me sukses vitin e parë të shërbimit të Korpusit të Paqes në komunitete në Mal të Zi përkrah partnerëve tanë, duke dëshmuar ndikimin pozitiv të mësimdhënies së përbashkët të gjuhës angleze në shkolla dhe duke ofruar veprimtari përforcuese passhkollore për fëmijët. Magjia e Korpusit të Paqes është e pranishme dhe pasqyrohet te njerëzit në Mal të Zi. Jam falënderuese për këtë gjë dhe mezi pres të punojmë së bashku për ta përçuar këtë magji në mbarë Malin e Zi në vitet e ardhshme. Jam krenare që vitin e kaluar shënuam mbi tre dekada të shërbimit të Korpusit të Paqes në Shqipëri. Vullnetarët tanë dhe homologët e tyre kanë dhënë kontribute me vlerë për sektorët e mësimdhënies së gjuhës angleze, edukimit shëndetësor dhe zhvillimit organizativ në shkolla, komunitete, organizata rinore, subjekte të shoqërisë civile dhe bashki që në fillimet e viteve nëntëdhjetë. Ndikimi i këtij kontributi është i dukshëm në bisedat e mia me njerëz nga i gjithë vendi, që nga Tirana e deri te shumë fshatra, ku vullnetarët kanë shërbyer gjatë 30 viteve të fundit.

U shpreh falënderimet e mia të përzemërta Vullnetarëve të Korpusit të Paqes, përkushtimi dhe pasioni i të cilëve vazhdojnë të jenë forca shtytëse e magjisë së Korpusit të Paqes. Angazhimi juaj i palëkundur për të nxitur ndryshimin pozitiv nuk kishte se si të mos vihej re. Po njësoj, një vlerësim i merituar shkon edhe për homologët tanë vendas, kolegët, nxënësit dhe të rinjtë, që kanë bashkëpunuar me zell dhe kënaqësi me Vullnetarët e Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi. Jap mirënjohjen time të thellë edhe për komunitetet dhe familjet pritëse që çelën zemrat dhe dyert e shtëpive të tyre për Vullnetarët tanë. Sistemi juaj i mbështetjes dhe mikpritjes mundësojnë një mjedis ku Vullnetarët tanë mund të zhvillohen dhe të krijojnë kontribute afatgjata. Sigurisht që e gjitha kjo nuk do të ishte e mundur pa qeveritë e vendit tonë pritës.



Mesazh nga Drejtorja për Vendin, Megan Wilson

Prandaj, shpreh vlerësimet e mia për Ministrinë e Arsimit në Shqipëri dhe Mal të Zi për bashkëpunimin e vazhdueshëm.

Gjithashtu, u jap mirënjohjen time të gjithë anëtarëve të stafit të Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi, puna e palodhur e të cilëve ka qenë shumë e rëndësishme për t'i orientuar dhe këshilluar Vullnetarët tanë dhe për t'u siguruar se janë të shëndetshëm dhe të sigurt që të shërbejnë në mënyrë efektive në komunitetet e tyre. Sinergjia mes VKP-ve tanë, stafit të KP-së, familjeve pritëse, qeverisë dhe partnerëve vendas është dëshmi e efektshmërisë së veprimit kolektiv.

Pasuria e shërbimit të Korpusit të Paqes karakterizohet nga ndikimi që Vullnetarët dhe homologët tanë lënë në komunitete, shkëmbimi kulturor që ata përjetojnë dhe marrëdhëniet e qëndrueshme që krijojnë. Së bashku, ne festojmë jo vetëm për arritjet e vitit të kaluar, por edhe trashëgiminë e qëndrueshme të paqes dhe miqësisë që kultivohet falë përkushtimit të palodhur të komunitetit tonë të Korpusit të Paqes, që kapërcen kohën dhe vendin.

Me mirënjohje të thellë, Margaret Wilson



Misioni dhe objektivat e Korpusit të Paqes

Në vitin 1961, presidenti John F. Kennedy themeloi Korpusin e Paqes për të nxitur të kuptuarit më të mirë dhe për të promovuar miqësinë mes amerikanëve dhe popujve të tjerë.

Misioni i Korpusit të Paqes është të nxisë paqen dhe miqësinë në botë, duke përmbushur tre qëllime:

1. Të ndihmojë popujt e shteteve të interesuara të përmbushë nevojat për burra dhe gra të trajnuar.
2. Të ndihmojë në promovimin e të kuptuarit më të mirë të amerikanëve nga ana popujve që u shërben.
3. Të ndihmojë në promovimin e të kuptuarit më të mirë të popujve të tjerë nga amerikanët.

Korpusi i Paqes ndryshon jetë; jetët e njerëzve në komunitetet në të gjithë botën dhe jetët e vullnetarëve.

- Më shumë se 235,000 amerikanë kanë shërbyer në Korpusin e Paqes në 142 shtete.



Korpusi i Paqes në Shqipëri

Në vitin 1991, qeveria Shqiptare ftoi SHBA-në të krijonte një program të Korpusit të Paqes në vend. Grupi i parë i Vullnetarëve mbërriti në Shqipëri në vitin 1992 për t'u angazhuar me mësimdhënien e gjuhës angleze në shkolla të arsimit të mesëm dhe në universitete. Nga viti 1993 deri në vitin 1996 katër grupe të tjera vullnetarësh mbërritën për të dhënë mësim në anglisht, për të mbështetur zhvillimin e bizneseve të vogla ose për të mbështetur menaxhimin e bujqësisë dhe pyjeve. Korpusi i Paqes mbylli programin e tij në Shqipëri në vitin 1997 për shkak të trazirave politike dhe shqetësimeve për sigurinë e Vullnetarëve.

Qeveria shqiptare ftoi Korpusin e Paqes të rihapte programin e tij në vitin 2002 dhe mori pjesë në një vlerësim të zhvilluar nga Korpusi i Paqes. Bazuar në këtë vlerësim, anëtarët e parë të Korpusit të Paqes u kthyen në mars të vitit 2003, ngritën një zyrë dhe ri-hapën programet.

Që nga shtatori i vitit 2003, vullnetarët kanë punuar me qeveritë vendore, OJQ-të, shkollat dhe institucionet shëndetësore në tre fusha:

- Mësimdhënia e gjuhës angleze
- Shëndetësia, tani me në fokus shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve
- Zhvillimi organizativ

Programi i Korpusit të Paqes është i pranishëm në Shqipëri me ftesë të qeverisë shqiptare dhe operon sipas një marrëveshjeje midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë që njeh rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me avantazhe reciproke.

Që nga shtatori i vitit 1992, mbi 900 vullnetarë kanë shërbyer në Shqipëri.



Korpusi i Paqes në Mal të Zi

Në vitin 2019, Korpusi i Paqes nënshkroi një marrëveshje dypalëshe me qeverinë e Malit të Zi duke krijuar një program në vend. Grupi i parë i Vullnetarëve të trajnuar mbërritën në janar të vitit 2020 dhe filluan trajnimin e tyre 10-javor para shërbimit. Në mars të vitit 2020, grupi u evakuua për shkak të pandemisë së Covid-19 përpara mbërritjes në komunitetet pritëse.

Në vijim të përgatitjeve të rëndësishme, Vullnetarët u kthyen në Mal të Zi në vjeshtë të vitit 2022 dhe pas një trajnimi të suksesshëm nisën shërbimin e Korpusit të Paqes në komunitetet malazeze për herë të parë. Kjo ngjarje shënoi një triumf simbolik kundrejt sfidave të dy viteve e gjysmë më parë dhe prania e tyre jo vetëm që rivendosi misionin e Korpusit të Paqes, por shërbeu edhe si një dëshmi e fuqishme për angazhimin ndaj shkëmbimit ndërkulturor dhe zhvillimin komunitar.

Në vjeshtë të vitit 2023, një grup tjetër Vullnetarësh të trajnuar mbërritën në Mal të Zi dhe filluan shërbimin në dhjetor të atij viti. Aktualisht, të gjithë 11 Vullnetarët në komunitetet malazeze shërbejnë në mësimdhënien e gjuhës angleze me homologët e tyre malazezë.

Programi i Korpusit të Paqes është i pranishëm në Mal të Zi me ftesë të qeverisë malazeze dhe operon sipas një marrëveshjeje midis Shteteve të Bashkuara dhe Malit të Zi që njih rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me avantazhe reciproke.



Kthimi historik i Vullnetarëve në vitin 2022 dhe grupi i ri i vitit 2023



Grupi i parë i Vullnetarëve u kthye në vitin 2022 pas pandemisë.



Pas tyre, në vitin 2023, mbërriti një grup tjetër prej 42 Vullnetarësh, nga të cilët 35 do të shërbenin në Shqipëri dhe 7 në Mal të Zi.

Në vitin 2022 ndodhi një ngjarje historike pasi Vullnetarët e Korpusit të Paqes u kthyen në Shqipëri dhe në Mal të Zi pas një pushimi të gjatë për shkak të pandemisë globale. Kthimi ishte pika kulmore e përgatitjeve nga stafi i Korpusit të Paqes, të cilët i kanë kaluar me sukses sfidat e hasura gjatë pandemisë, duke garantuar sigurinë dhe mirëqenien e Vullnetarëve si dhe të komuniteteve pritëse. Kthimi i Vullnetarëve shërbeu si dëshmi e angazhimit të palëkundur të Korpusit të Paqes për nxitjen e paqes dhe bashkëpunimit në të gjithë globin.

Në vitin 2023, me mbërritjen e një grupi të ri të trajnuarish të zellshëm u hap një kapitull i ri në trashëgiminë e Korpusit të Paqes. Ata e nisën udhëtimin e tyre transformues plot emocion dhe përkushtim për të shërbyer në komunitetet e tyre pritëse. Mbërritja e tyre shënoi fillimin premtues të një epoke vullnetarizmi, përfshirjeje kulturore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, pasi ishin të përgatitur për të marrë përsipër sfidat dhe përgjegjësitë e shërbimit të Korpusit të Paqes me të njëjtin zell dhe përkushtim si paraardhësit e tyre, duke vazhduar kështu misionin e organizatës për promovimin e paqes dhe mirëkuptimit.

17

vullnetarë
kthehen për
të shërbyer
në Shqipëri
dhe Mal të Zi
në vitin 2022

42

të trajnuar të rinj
mbërrijnë në SHBA
në vitin 2023 për t'iu
bashkuar shërbimit
në Shqipëri dhe Mal
të Zi

Prezantimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi

Vullnetarët e Korpusit të Paqes vijnë nga të gjitha cepat e Shteteve të Bashkuara për të sjellë ndryshime rrënjësore në Shqipëri dhe Mal të Zi. Vullnetarët shkëmbejnë vlerat dhe perspektivat e tyre të origjinës me komunitetin pritës në të cilin shërbejnë, një shkëmbim ndërkulturor që lë pas paqe dhe miqësi.




“Ky vlerësim nga ana juaj më bën që t’ju kërkoj të qëndroni me ne përgjithmonë.

Më keni lënë shumë mbresa!!
Ju falënderoj!!!”

- një nxënës pas vlerësimit të marrë nga një mësues VKP

Prezantimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi

Mosha kur mbërritën në Shqipëri



“Ai nuk është thjesht një mësues, është shembull i mirësjelljes, bujarisë dhe profesionalizmit. Sjellja e tij e mirë dhe qasja e mençur që përdor krijon një klimë pozitive në klasën tonë. Bujaria e tij shkon përtej kurrikulës e ai kujdeset për mirëqenien dhe rritjen tonë”.

një Homolog për një Vullnetar

1

Vullnetar i bashkuar
KP-së menjëherë pasi u bë
shtetas i SHBA-së

3

VKP-të kanë shërbyer më
parë në Korpusin e Paqes!

ARSIMI



(5%)

(36%)

(59%)

Vullnetarët mobilizojnë fuqinë e të rinjve, duke krijuar udhëheqës të së nesërme përmes partneritetit strategjik me homologët vendas

Vullnetarët e Korpusit të Paqes luajnë rol të rëndësishëm për të nxjerrë në pah potencialin e të rinjve shqiptarë dhe malazezë, duke nxitur shfaqjen e udhëheqësve të rinj dinamikë të së nesërme. Përkushtimi i tyre dhe përpjekjet e palodhura i fuqizojnë të rinjtë në këto rajone për të shpalosur potencialin e tyre, duke i pajisur me aftësi dhe dije themelore, me një ndjenjë qëllimi dhe duke nxitur një frymë përgjegjësie për komunitetet e tyre. Duke nxitur mirëkuptimin ndërkulturor dhe duke lehtësuar zhvillimin e qëndrueshëm, këta Vullnetarë shërbejnë si katalizatorë për ndryshimin pozitiv, duke fuqizuar kështu rininë vendase për t'u bërë forca shtytëse për ecurinë e vendit të tyre.



Për më tepër, Vullnetarët e Korpusit të Paqes nuk veprojnë vetëm; ata bashkëpunojnë në mënyrë strategjike me partnerët vendas në Shqipëri dhe në Mal të Zi, duke krijuar lidhje që zgjerojnë mbulimin dhe ndikimin e nismave të tyre. Ky partneritet harmonik forcon bazën e një zhvillimi të drejtuar nga komuniteti, duke garantuar që ndryshimi i të sotmes do t'u përshtatet brezave të ardhshëm. Teksa bota vijon të zhvillohet, këta vullnetarë të përkushtuar shërbejnë si pishtarë shprese, duke bashkuar kulturat dhe duke i pajisur të rinjtë me aftësitë dhe frymëzimin e nevojshëm për t'u bërë prijës largpamës të një të ardhmeje më të bashkuar.



Mësueset Vullnetare të Korpusit të Paqes, Maria dhe Patti në Mal të Zi, shërbejnë krahë kolegëve të tyre vendas në shkollë të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë përmes mësimdhënies së përbashkët të gjuhës angleze.

Zhvillimi i Vullnetarëve fillon me mbërritjen e tyre dhe vazhdon gjatë shërbimit

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi u ofron Vullnetarëve një program trajnimi gjithëpërfshirës të hartuar për t'i pajisur ata me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të shërbyer në komunitete të larmishme në të dyja vendet. Ky trajnim përfshin elemente të ndryshme, duke filluar nga trajnimi intensiv gjuhësor, që u mundëson Vullnetarëve të komunikojnë në mënyrë efektive me popullsinë vendase dhe të krijojnë marrëdhënie të forta. Trajnimi teknik ka në fokus aftësitë e veçanta dhe ekspertizën e nevojshme për çdo rol caktuar vullnetarëve, duke garantuar se mund të kenë ndikim domethënës në fushat e projektit të tyre. Trajnimi për kompetencën kulturore është një komponent bazë, që nxit të kuptuarit e thelluar për kulturën dhe zakonet e vendit pritës. Gjithashtu, trajnimi për diversitetin, barazinë dhe përfshirjen thekson rëndësinë e respektimit dhe vlerësimit të dallimeve, duke krijuar një përvojë më gjithëpërfshirëse dhe harmonike për Vullnetarët. Trajnimi për shëndetin dhe mirëqenien i përgatit vullnetarët në aspektin fizik dhe mendor për sfidat e veçanta të shërbimit të tyre, ndërsa trajnimi për sigurinë dhe sigurimin i pajis ata me mjetet e nevojshme për të kaluar rreziqet dhe emergjencat e mundshme. Së bashku, këto elemente të trajnimit të Korpusit të Paqes ofrojnë një bazë gjithëpërfshirëse për shërbimin e suksesshëm dhe kontribuojnë në misionin e organizatës për të promovuar paqen dhe bashkëpunimin përtej kufijve. Trajnimi i vullnetarëve ofron një përvojë shumëdimensionale të nxëni, që jo vetëm i përgatit Vullnetarët për shërbimin e tyre, por edhe i ndihmon ata në rritjen e tyre si individë.



Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi në fund të vitit 2023



- 58 VKP
 - 11 në Mal të Zi
 - 47 në Shqipëri
- 4 sektorë
 - Mësimdhënia e gjuhës angleze në Shqipëri
 - Mësimdhënia e gjuhës angleze në Mal të Zi
 - Edukimi shëndetësor
 - Zhvillimi organizativ
- Vazhdimësia e partneritetit me shkollat, bashkitë, ministritë dhe OJQ-të, dhe kalimi i emërimeve në komunitete më të vogla, që kanë më pak burime.
- Vëmendja e shtuar ndaj çështjeve të lidhura me shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve, përvetësimin e gjuhës angleze dhe fuqizimin e shkollave, zhvillimin e turizmit dhe qëndrueshmëria e projekteve përmes pronësisë dhe mbështetjes vendore.



Objektivat e vitit 2023 sipas sektorit

Edukimi shëndetësor

1: Shtimi i njohurive dhe aftësive të fëmijëve dhe të rinjve për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e tyre përmes edukimit shëndetësor dhe aftësimit për jetën.

2. Shtimi i kapaciteteve të stafit shkollor për të ofruar edukim rreth shëndetit dhe aftësive për jetën.

3. Zhvillimi dhe shtimi i bashkëpunimit me ofruesit

Zhvillimi organizativ dhe i komunitetit

1. Fuqizimin e kapaciteteve të organizatave për të përmirësuar shërbimet që u ofrojnë anëtarëve të tyre.

2. Fuqizimin e kapaciteteve të organizatave për të ofruar zhvillim profesional dhe mundësi angazhimi qytetar për anëtarët e komunitetit.

Mësimdhënia e gjuhës angleze

1. Rritja e kompetencave në gjuhën angleze dhe e kapacitetit për përdorimin e gjuhës angleze dhe praktikave të mësimdhënies me barazi gjinore.

2. Shtimi i arritjeve të nxënësve në gjuhën angleze dhe përforcimi i aftësive për jetën.

3. Rritja e aftësisë së anëtarëve të komunitetit për të mbështetur aksesin e nxënësve të nxënësve.

Projektet e KPSHM-së: Zhvillimi organizativ (ZHO)

Qëllimi i Projektit: Menaxhimi efektiv i zhvillimit të komunitetit nga individët, organizatat dhe komunitetet e fuqizuara shqiptare.

Projekti i KPSHM-së për zhvillimin organizativ synon të fuqizojë kapacitetin organizativ në nivel vendor përmes caktimit të Vullnetarëve në punë në agjenci qeveritare dhe OJQ. Vullnetarët promovojnë qasje të mbështetura në vlera për zhvillimin e komunitetit, angazhimin e shoqërisë civile, qeverisjes së mirë dhe krijimin e lidhjeve mes palëve të interesit.

Shembull i një veprimtarie Vullnetari:

VKP-ja për ZHO-në, Rakesh-i, dhe bashkëpuntorja e tij OJQ-ja “Porta Rome për Integrim” punojnë së bashku për të ofruar edukim shtesë dhe trajnim mbi aftësitë për jetën dhe mentorim për t’u përcjellë besim dhe frymëzim fëmijëve romë. Kjo mbështetje synonte fuqizimin e këtyre fëmijëve për të përfunduar arsimimin e tyre gjatë shkollës së mesme, gjë që rrallëherë ndodh në komunitetin e tyre. Lidhur me këtë aspekt, ata mbështetën 27 fëmijë romë me orë shtesë mësimore, trajnim mbi aftësitë për jetën dhe zhvillimin e karakterit. Në të njëjtën kohë, Rakesh-i dhe partnerët e tij po themelojnë programin “Vëlla i madh, motër e madhe” për të angazhuar 27 gjimnazistë vendas, që do të trajnohen si mentorë dhe do të punojnë me nga një fëmijë rom secili. Ky projekt synonte të angazhonte të gjithë komunitetin duke punuar ngushtë me prindërit për t’i fuqizuar që të mbështesin arsimimin e fëmijëve të tyre.



14 vullnetarë që shërbyen në këtë sektor gjatë periudhës 2022/2023

17 organizata komunitare të mbështetura nga Vullnetarët për të zgjeruar mundësitë për angazhim qytetar

168 pjesëmarrës në aktivitete vullnetare të organizuara nga Vullnetarët dhe homologët e tyre

58 projekte të zbatuara nga Vullnetarët e OZH-së dhe Homologët

Projekti i KPSHM-së: Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve

Qëllimi i Projektit: Fuqizimi dhe informimi i fëmijëve dhe të rinjve për të pasur një jetë të shëndetshme dhe për t'u kthyer në të rritur produktivë dhe të përkushtuar.

Duke i caktuar Vullnetarët në shkolla për të punuar krahë mësuesve dhe homologëve të komunitetit, projekti për edukimin mbi shëndetin synon të rrisë njohuritë dhe aftësitë e fëmijëve dhe të rinjve me qëllim përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tyre, rritjen e kapaciteteve të stafit shkollor për të ofruar edukim mbi shëndetin dhe aftësitë për jetën dhe rritjen e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe partnerët komunitarë.

Veprimtaria e Vullnetarëve: Rritja e ndërgjegjësimit për Ditët Botërore të Shëndetit

Gjatë vitit shkollor, Vullnetarët e edukimit shëndetësor u koordinuan për të organizuar aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit për Ditët Botërore të Shëndetit, si Dita e Epilepsisë, Dita e Shëndetit Mendor, Dita e Sigurisë Ushqimore, etj. Vullnetarët bashkëpunuan me homologët e tyre në shkollë dhe ofruesit vendas të shëndetit për të lehtësuar orët mësimore kurrikulare dhe ekstrakurrikulare si dhe aktivitetet për të ofruar informacion të bazuar në evidenca përmes teknikave ndërvepruese. Këto aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimin mbi shëndetin mbështetën nxënësit për të pasur jetë më të shëndetshme dhe të fuqizuara.



Dita Botërore e Shëndetit

Mendor

17 vullnetarë që shërbyen në këtë sektor gjatë periudhës 2022/2023

63 punonjës stafi shkolle të orientuar për të përdorur teknika novatore për të thjeshtuar kurrikulat me barazi gjinore për shëndetin dhe aftësitë për jetën

877 pjesëmarrësve iu ofrua trajnim individual ose në grup mbi shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve

Projekti i KPSHM-së: “TEFL” në Shqipëri

Qëllimi i Projektit: Zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës angleze për nxënësit dhe mësuesit shqiptarë.

Programi “TEFL” në Shqipëri synon të përmirësojë nivelin e kompetencave të mësuesve dhe nxënësve në gjuhën angleze, të rrisë kapacitetet e mësuesve për përdorimin e aftësive të përgjithshme të mësimdhënies dhe atyre të gjuhës angleze dhe të rrisë aftësitë e anëtarëve të komunitetit për të mbështetur mësimnxënien. Vullnetarët në Shqipëri së bashku me mësuesit shqiptarë japin mësim dhe zhvillojnë veprimtari ekstrakurrikulare si dhe projekte që synojnë t’i pajisin të rinjtë vendas me aftësi për jetën dhe udhëheqëse.

Veprimtaria e Vullnetarëve: *Kamp teatri*

Krahas mësimdhënies së përbashkët në klasë, Vullnetarët për “TEFL” zakonisht bashkëpunojnë me homologë për të zhvilluar veprimtari të kombinuara me zhvillimin e aftësive të avancuara në gjuhën angleze. VKP-ja Andrew vuri re interesin e nxënësve të tij për aktrimin dhe përdori aftësitë e tij të shkruarit dhe bashkë me dy homologët e tij hartuan një plan për një kamp teatri. Një nga homologët e tij ishte aq e emocionuar sa mori pjesë edhe si nxënëse.

Për rrjedhojë, 16 pjesëmarrës mësuan aftësi si gramatika e aktrimit dhe shkrimi i shfaqjeve. Për më tepër, duke marrë parasysh kombinimin e kompetencave në gjuhën angleze dhe inteligjencës emocionale të nevojshme për të aktruar, pjesëmarrësit fituan besimin e duhur për të komunikuar në anglisht, gjë që ishte një përvojë e paçmueshme. Kur i pyetëm se çfarë mund të përmirësojmë në vijim, ata njëzëri kërkuan një kamp më të gjatë, pasi jo vetëm që kishin mësuar aftësi të veçanta në gjuhën angleze, por edhe ishin kënaqur.



Një nxënëse duke performuar

16 Vullnetarë që shërbyen në këtë sektor gjatë periudhës 2 dhjetor 2022-15 dhjetor 2023

89 të rinj që morën pjesë në veprimtari për zhvillimin e të rinjve, organizuar nga Vullnetarët dhe homologët vendas

489 nxënës në klasa vullnetare, që treguan arritjet e tyre në gjuhën angleze.

Projekti i KPSHM-së: “TEFL” në Mal të Zi

Qëllimi i Projektit: Zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës angleze për mësuesit dhe nxënësit malazezë.

Përmes punës së Vullnetarëve të caktuar për mësimdhënie të përbashkët në shkolla në Mal të Zi, programi “TEFL” synon të përmirësojë nivelin e kompetencave të nxënësve dhe mësuesve në gjuhën angleze, të rrisë kapacitetet e mësuesve për përdorimin e aftësive të përgjithshme të mësimdhënies dhe atyre të gjuhës angleze. Gjithashtu, Vullnetarët në Mal të Zi mbështesin nevojën për veprimtari ekstrakurrikulare si dhe projekte që synojnë t’i pajisin të rinjtë vendas me aftësi për jetën dhe udhëheqëse.

Shembull i një veprimtarie Vullnetari: Klubi i gjuhës angleze

Vullnetarja e Korpusit të Paqes, Patti, dhe homologët Dana dhe Adnan krijuan një klub të gjuhës angleze për fëmijët dhe të rriturit e komunitetit të saj. Teksa fliste për idenë, Patti tha: “Në mesin e muajit korrik, përveshëm mëngët, morëm kovat, furçat dhe dezinfektuesit për të transformuar një kafene të lënë pas dore e të pafrekuentuar, në një ambient të hapur e me dritë për fëmijë e të rritur. Donim t’u ofronim fëmijëve dhe të rriturve vendas një vend për të shprehur veten në gjuhën angleze përmes artit, muzikës, filmit dhe bisedave. Klubi ofronte tre seanca të veçanta për tre audiencë të ndryshme. Një seancë u dedikohej nxënësve të fillores nga 6-12 vjeç, e dyta për nxënësit e moshave 13-16 vjeç dhe grupi i tretë përbëhej nga të rritur, që po mësonin gjuhën për herë të parë. Klubi u bë shumë i njohur dhe rinisi semestrin e parë shkollor të vitit 2023.



Çdo anëtar klubi ngjyrosi nga një tullë, që përfaqësonte personalitetin e tij unik

11 vullnetarë që shërbyen në këtë sektor gjatë periudhës 2022/2023

88 të rinj që morën pjesë në veprimtari për zhvillimin e të rinjve, organizuar nga Vullnetarët dhe homologët vendas

1003 nxënës në klasa vullnetare, që treguan arritjet e tyre në gjuhën angleze.

Ndarja e kulturës dhe traditave amerikane

Vullnetarët e Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi angazhohen aktivisht në ndarjen e kulturës amerikane përmes një shumëllojshmërie nismash me ndikim. Ata organizojnë evente për shkëmbim kulturor, si klubet e gjuhëve, ku u prezantojnë komuniteteve vendase aspekte gjuhësore, të traditave dhe të jetës së përditshme. Shpesh, Vullnetarët bashkëpunojnë me shkollat vendase për të zhvilluar orë mësimore ndërvepruese rreth historisë, letërsisë dhe zakoneve amerikane, duke ofruar një përvojë të drejtpërdrejtë të diversitetit të kulturës amerikane. Gjithashtu, projektet komunitare, si organizimi i bisedave për filma, forumeve të diskutimit, ose eventeve muzikore me artistë amerikanë, shërbejnë si platforma efektive për shkëmbimin kulturor.

Mësuesit VKP kontribuojnë te shkëmbimi kulturor përmes eventeve edukative si “Spelling Bee” (konkurs germëzimi), duke ofruar një platformë argëtuese dhe edukative ku nxënësit mund të ndërveprojnë në gjuhën angleze. Këto evente jo vetëm që përmirësojnë aftësitë gjuhësore, por i njohin nxënësit me traditat amerikane edukative. Festime të veçanta si Dita e Pavarësisë apo Dita e Falënderimeve karakterizohen nga mbledhjet komunitare, festa ku secili sjell gatimin e tij dhe aktivitete që u mundësojnë vendasve të prekin nga afër dhe të vlerësojnë traditat amerikane. Nëpërmjet këtyre nismave, Vullnetarët kontribuojnë në nxitjen e mirëkuptimit të përbashkët, ndërtimin e urave lidhëse mes kulturave dhe krijimin e lidhjeve afatgjata mes popullit shqiptar, malazez dhe amerikan.

Që prej kthimit të tyre, të trajnuarit e Korpusit të Paqes e kanë bërë traditë të organizojnë **festa ku secili sjell gatimet e tij për Ditën e Falënderimeve** së bashku me partnerët vendas shqiptarë gjatë periudhës së trajnimit të tyre. Kjo ngjarje ndan kulturën amerikane përmes përjetimit të kësaj tradite të dashur, duke krijuar ndjenjën e bashkimit dhe mirëkuptimit. Gjatë kësaj feste, ku secili solli gatimet e tij, jo vetëm që u prezantuan gatimet e shumëllojshme amerikane, por u dha edhe mundësia për dialog të hapur ku Vullnetarët dhe homologët e tyre shqiptarë shkëmbyen histori, pikëpamje dhe përvoja gatimi. Përmes kësaj përpjekjeje bashkëpunuese, u bë i mundur sheshimi i kufijve kulturorë dhe fuqizimi i lidhjeve si dhe doli në pah vlerësimi i madh i traditave të njëri-tjetrit.

A Thanksgiving-themed poster for a Peace Corps event. The background is dark blue with orange and yellow autumn leaves and red berries. At the top left is the Peace Corps logo (a white dove) and the text "Peace Corps ALBANIA AND MONTENEGRO". Below this is the text "FOOD, AMERICAN AND ALBANIAN MUSIC" in white. The main title "THANKS GIVING" is in large, bold, yellow letters. Below it is a yellow banner with the word "Potluck" in white script. In the center is a large, detailed illustration of a roasted turkey surrounded by pumpkins and autumn leaves. At the bottom, the date and time "25TH NOVEMBER, 2023 SATURDAY, 1:30 PM" are written in white. Below that is the location "Shkolla Besëlidhja, Lezhë" in white. At the very bottom, a red banner contains the text "Peace Corps Albania and Montenegro is so thankful for you" in white. Below the red banner is the contact information "Contact: gleka@peacecorps.gov" in white.

Peace Corps
ALBANIA AND
MONTENEGRO

FOOD, AMERICAN AND ALBANIAN MUSIC

THANKS GIVING

Potluck

25TH NOVEMBER, 2023
SATURDAY, 1:30 PM

Shkolla Besëlidhja, Lezhë

Peace Corps Albania and Montenegro is so thankful for you

Contact: gleka@peacecorps.gov

*Banderolë ftese për kremtimin e Ditës së
Falënderimeve*

Ndarja e kulturës shqiptare dhe malazeze



Peace Corps Albania

8.7K followers • 35 following

Posts About Photos Videos

Intro

Life is calling. How far will you go? For information on Peace Corps Albania visit <http://albania.pe>

Page · Government organization



Peace Corps Albania

23h ·

FIRST PRACTICUM DAYS WITH THE PEACE CORPS – WHERE PASSION MEETS PRACTICE!

Our trainees, equipped with the skills of English teaching, health education, and organizational development, are seizing the opportunity to put their knowledge into action. From classrooms to communities, they're diving into their first practicum days with passion



Peace Corps in Montenegro

567 followers • 25 following

Posts About Photos Videos

Intro

Life is calling. How far will you go? For information on Peace Corps Montenegro visit <https://www.pe>

Page · Government organization



Peace Corps in Montenegro

23h ·

PRVI DANI PRAKTIKUMA U MIROVNOM KORPUSU – GDJE SE STRAST ZA NASTAVOM SRUJE SA PRAKSO!MI

Naši polaznici, obučeni potrebnim znanjem neophodnim za podučavanje engleskog jezika, koriste priliku da naučeno pretvore u djelo. Od učionice do zajednice, oni započinju svoje prve dane praktikuma sa strastu i svrhom. Spremnii su da ostave značajan tra

Korpusi i Paqes ndan në mënyrë efektive kulturën shqiptare dhe malazeze me amerikanët përmes platformave të mediave sociale dhe duke i inkurajuar Vullnetarët e kthyer të vazhdojnë të promovojnë shkëmbimin kulturor edhe pas përfundimit të shërbimit të tyre. Vullnetarët e Korpunit të Paqes i përdorin aktivisht mediat e tyre sociale për t'i ndarë dhe për t'u dhënë zë historive të jetës së tyre dhe gjatë shërbimit, duke ofruar një vështrim në mozaikun e kulturës shqiptare. Vullnetarët ndajnë përvojat e tyre përmes blogjeve, postimeve dhe materialeve multimediale, duke nxitur të kuptuarit më të thellë të zakoneve, traditave dhe jetës së vendasve të të dyja vendeve.

Gjithashtu, kur Vullnetarët kthehen në shtëpi, ata marrin pjesë në aktivitete si prezantime me komunitetin, workshop-e kulturore dhe seancave të rrëfimit për të ndarë përvojat e tyre nga shërbimi me bashkëkombës amerikanë. Duke përfshirë elemente të kulturës shqiptare dhe malazeze në këto aktivitete, ata kontribuojnë në vlerësimin më të gjerë të diversitetit në botë. Përmes përpjekjeve të tilla të vazhdueshme, Vullnetarët e Korpunit të Paqes vazhdojnë të mishërojnë idealet e Korpunit të Paqes, duke shërbyer si ambasadorë kulture dhe duke nxitur mirëkuptimin kulturor mes Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe Shteteve të Bashkuara.

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar: Shërbimi virtual

Nisma për shërbim virtual:

Në vitin 2020, Korpusi i Paqes prezantoi Platformën Pilot për Shërbime Virtuale (PPSHV) si një mënyrë novatore për të vazhduar misionin dhe synimet e KP-së edhe gjatë pandemisë së COVID-19. PPSHV-ja u projektua për të provuar realizueshmërinë e angazhimit virtual dhe për momentin është e hapur për çdo Vullnetar të Kthyer të Korpusit të Paqes (VKKP). Pjesëmarrësit në Platformën Pilot për Shërbime Virtuale (PPPSHV) janë qytetarë, që ia ofrojnë kohën dhe shërbimet e tyre vullnetare agjencisë për t'u bërë virtualisht pjesë e angazhimeve pesë deri në pesëmbëdhjetë orë në javë me partnerë të komunitetit për një periudhë prej tre deri në gjashtë muaj.

Shërbimi virtual në Shqipëri dhe Mal të Zi:

Që në fillim të PPSHV-së në vitin 2020, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi ka krijuar 12 angazhime për Shërbime Virtuale në bashkëpunim me organizata partnere vendase në të dyja vendet, nga të cilat një pjesë kanë përfunduar dhe pjesa tjetër janë në proces zbatimi. Këto angazhime i kanë mundësuar KPSHMZ-së të krijojë partneritete dhe të mbështesë partnerët aktualë e organizatat partnere në Tiranë ose Podgoricë, ku VKP-të nuk mund të shërbejnë.

Dymbëdhjetë VKKP-të, që ia kanë dedikuar kohën e tyre shërbimit virtual, kanë kontribuar në aktivitete të lidhura me zhvillimin e kurrikulës, përvetësimin e gjuhës angleze, zhvillimin e drejtuesve, mbledhjen e fondeve, e shumë të tjera. Që prej janarit të vitit 2024, janë në proces zbatimi tre angazhime për Shërbime Virtuale.



Vullnetari i Korpusit të Paqes, Brad, i kthyer nga Shqipëria duke biseduar me studentë universiteti në Tiranë


12 angazhime për Shërbime Virtuale në Shqipëri dhe Mal të Zi që nga fillimi i pilotimit me shkollat, institucionet e arsimit të lartë, OJQ-të dhe agjencitë qeveritare.

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar -Mbështetja e rekrutimit të Vullnetarëve-

Nevoja: Në përgjigje të kërkesës në rritje për individë të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi identifikuan nevojën për përforsimin e fuqisë vullnetare. Për të trajtuar këtë nevojë, u ndërmor një nismë proaktive për rekrutim përmes një postimi dhe angazhimit në aktivitete të shumëllojshme për të tërhequr vullnetarë të mundshëm.

Aktivitetet: Një nismë e rëndësishme përfshiu organizimin e një webinar-i për të treguar përvojën transformuese të të shërbyerit si Vullnetar i Korpusit të Paqes (VKP) në Shqipëri dhe në Mal të Zi. Në përputhje me fushatën globale “Shërbe me Vendosmëri” (Serve Boldly) nga Selia Qendrore e Korpusit të Paqes, webinar-i synoi të frymëzonte vullnetarët e ardhshëm për të mirëpritur sfidat dhe shpërblimet e shërbimit ndërkombëtar. Po ashtu, postimi ynë intensifikoi përpjekjet për mbulim duke nxitur lidhjet me VKKP-të e Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi dhe rrjetet e mediave sociale të ndjekësve përmes kanaleve të ndryshme, përfshirë platformat e mediave sociale. Korpusi i Paqes synoi që përmes përhapjes së gjuhës dhe thirrjeve për rekrutimin e Vullnetarëve, të krijonte një rrjet të gjerë dhe t’u përshtatej individëve të pasionuar për të lënë ndikim pozitiv. Kjo qasje e shumanshme u shtri përtej kufijve fizikë, pasi organizata inkurajoi në mënyrë aktive pjesëmarrjen në Shërbimin Virtual, duke krijuar ndjenjën e një komuniteti global, teksa u shërbente nevojave unike të komuniteteve vendase në Shqipëri dhe Mal të Zi.

Ndikimi: Duket se pika kulmore e këtyre përpjekjeve ka pasur ndikim të thellë në aspektin e rekrutimit, duke siguruar kështu tërheqjen e një grupi të qëndrueshëm dhe të larmishëm Vullnetarësh të Trajnuar të angazhuar për të çuar përpara misionin e Korpusit të Paqes.



“Ndërlidhu me Korpusin e Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi” ishte një nga nismat e postimit për të mbështetur përpjekjet për rekrutimin e Vullnetarëve

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar

-Komiteti i Përmirësimit të Shërbimit-

Komiteti i Përmirësimit të Shërbimit

Në prill të vitit 2023, KPSHMZ-ja prezantoi me kënaqësi Komitetin Këshillimor të Vullnetarëve me emrin Bordi i Përmirësimit të Shërbimit. Pozitiv ishte fakti që nga çdo sektor mund të zgjidhej nga një Vullnetar për t'u bashkuar. Falënderojmë VKP-të Katie, Sebastian, Angela dhe Maria për angazhimin dhe interesin e tyre! Qëllimi i Komitetit të Përmirësimit të Shërbimit Shqipëri dhe Mali i Zi është:

- Të ofrojë mundësinë për dialog mes stafit dhe Vullnetarëve, duke pasur në fokus qëllimet e përbashkëta të rrënjosura në misionin e Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi.
- Të shërbejë si mekanizëm për vlerësim të përbashkët dhe ndërveprimit të dobishëm mes Vullnetarëve dhe stafit për të fuqizuar programin, trajnimin dhe operacionet e KPSHMZ-së në mbështetje të komuniteteve pritëse.
- Të jetë një mekanizëm për anëtarët e komitetit, për të komunikuar, mbështetur dhe për të marrë miratim nga komuniteti i Vullnetarëve për ndryshime politikash ose nisma të drejtuara nga stafi.
- Të ofrojë një platformë për lidhjen e partneriteteve mes stafit dhe Vullnetarëve për të mbështetur shërbimin profesional dhe efektiv.



Anëtarët e Përmirësimit të Shërbimit dhe drejtuesit e KPSHMZ-së në vitin 2023

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar -Rrjeti i Mbështetjes nga Kolegët-

Rrjeti i Mbështetjes nga Kolegët

KPSHMZ-ja kishte kënaqësinë që në prill të vitit 2023 të prezantonte sërish Rrjetin e Mbështetjes nga Kolegët. Rrjeti i Mbështetjes nga Kolegët (RRMK) është një komitet i zyrtarizuar për mbështetjen nga kolegët që përgjithësisht synon të promovojë mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e Vullnetarëve gjatë shërbimit. RRMK-ja përbëhet nga Vullnetarë të trajnuar për të ofruar mbështetje për kolegët, për të planifikuar dhe siguruar mbulim gjithëpërfshirës, për t'i drejtuar Vullnetarët te burimet e përshtatshme dhe për të pasur një programim të qëndrueshëm. Jemi të kënaqur që si anëtarë kemi nga dy vullnetarë nga secili program për vendin. Falënderojmë Aleksandra-n, Alex-in, Patti-n dhe Sebastian-in për përkushtimin dhe angazhimin duke mbështetur të tjerët! Një falënderim shkon edhe për punonjësit e shëndetësisë, që kanë punuar me anëtarët për ta bërë RRMK-në efektive. RRMK-ja synon promovimin e mirëqenies dhe qëndrueshmërisë së Vullnetarëve duke fuqizuar sistemet e mbështetjes në vend përmes përkrahjes private dhe empatike nga kolegët, mbulimit gjithëpërfshirës për të gjithë Vullnetarët, drejtimit të burimet dhe programimit të qëndrueshëm.



Anëtarët e RRMK-së për Korpusin e Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi gjatë periudhës 2022-2023

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar

-Grupi i Punës për Komunikimet-

VKP-të e para për Komunikimet - Grupi i Punës së Stafit

Fuqizojmë ndryshimin përmes lidhjeve! Në vitin 2022, prezantuar Grupin e parë të Punës për Komunikimet e Stafit dhe Vullnetarëve të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi. Së bashku do t'i japim zë ndikimit tonë, do të ndajmë histori frymëzuese dhe do të krijojmë një ndjenjë të fortë komuniteti. 🤝

🌟 Na pret një e ardhme emocionuese teksa mobilizojmë fuqinë e ndërlihdhjes për t'i dhënë zë ndikimit tonë. Na ndiqni në rrjetet tona sociale dhe bashkohuni me ne në udhëtimin tonë emocionues ku formësojmë narrativa, krijojmë lidhje dhe përhapim frymën e paqes dhe bashkimit!



Diskutimet për lehtësimin e hartimit të Raportit Vjetor zhvillohen në Grupin e Punës për Komunikimet e Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi.

Mbështetja administrative efektive e operacioneve të Korpusit të Paqes

Ekipi administrativ i Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi luan rol thelbësor në sigurimin e zbatimit të programeve tona pa probleme, duke ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse për stafin dhe Vullnetarët. Në krye të përgjegjësi të këtij ekipi qëndron menaxhimi i kujdesshëm i pagesave për të mbuluar shpenzimet e jetesës, për të garantuar mirëqenien financiare të Vullnetarëve tanë. Ekipi shkëlqen në koordinimin e logjistikës, përfshirë sigurimin e vendeve për seancat e trajnimit dhe ofrimin e mbështetjes së duhur përmes fazave të planifikimit dhe të ekzekutimit. Ekspertiza e tij përfshin koordinimin me efikasitet të transportit, duke mundësuar lëvizjen pa probleme të personelit dhe burimeve.

Gjatë periudhës së trajtuar nga ky raport, theksojmë me kënaqësi rolin e rëndësishëm të ekipit administrativ për procesin e punësimit të kolegëve të rinj. Koordinimi dhe menaxhimi i aspekteve të ndryshme të burimeve njerëzore nga ana e tij, përfshirë programet e trajnimit të stafit, kanë dhënë kontribut të vlefshëm për mirëfunksionimin e KPSHMZ-së dhe mirëqenien e përgjithshme të stafit tonë. Angazhimi i ekipit në nisma të vazhdueshme trajnimi siguron që personeli ynë të jetë i pajisur me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kapërcyer sfidat e veçanta të roleve të tij. Përtej roleve specifike, njësia e administrimit shërben si baza e suksesit operacional, përmes mbikëqyrjes së funksioneve të shumta që kontribuojnë në efektivitetin e përgjithshëm të nismave të Korpusit të Paqes. Menaxhimi i mirë i detyrave administrative nga ana e saj u mundëson vullnetarëve dhe stafit të përqendrohen te objektivat e tyre kryesore. Përkushtimi dhe kompetenca e ekipit të administrimit kontribuon ndjeshëm te suksesi dhe ndikimi i përpjekjeve të Korpusit të Paqes në rajon.



Gjatë vitit, stafi merr pjesë në trajnime të vazhdueshme, por edhe në aktivitete për mirëqenien.

Ne ofrojmë shërbime gjithëpërfshirëse mjekësore për Vullnetarët tanë

Shëndeti dhe mirëqenia e Vullnetarëve të Korpusit të Paqes që shërbejnë në vendet pritëse janë shumë të rëndësishme për Korpusin e Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi. Punonjësit e shëndetësisë e Korpusit të Paqes (PSHKP-të) dhe ekspertët vendas luajnë rol thelbësor për drejtimin e nismave që synojnë ofrimin e shërbimeve mjekësore gjithëpërfshirëse për Vullnetarët tanë. Ne e trajtojmë shëndetin e Vullnetarëve tanë me seriozitetin më të madh, duke marrë parasysh se mirëqenia e tyre fizike dhe mendore është jetike për aftësinë e tyre për të kontribuar në mënyrë efektive në komunitetet e tyre.

PSHKP-të tona kanë bashkëpunuar në mënyrë të zellshme me ofruesit dhe strukturat mjekësore në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ekipi ynë i dedikuar i mjekëve ka vizituar dhe inspektuar spitalet nga afër, duke lidhur marrëveshje strategjike për t'u siguruar Vullnetarëve tanë akses të shpejtë dhe efektiv në kujdes shëndetësor cilësor. Ky angazhim thekson përkushtimin e Korpusit të Paqes për ruajtjen e shëndetit të Vullnetarëve tanë duke u mundësuar të përfshihen në misionin e tyre me besim dhe qëndrueshmëri.



Siguria dhe sigurimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe Fuqizimi i stafit përmes ekspertizës në siguri dhe sigurim

Mbështetja e sigurisë dhe sigurimit të Vullnetarëve të Korpusit të Paqes:

Siguria dhe sigurimi i Vullnetarëve tanë janë të rëndësishme dhe përbëjnë bazën e misionit të Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi. Duke marrë parasysh faktin që siguria luan rol të rëndësishëm në mirëqenien e Vullnetarëve, stafi i KPSHMZ-së i përkushtohet ofrimit të një mjedisi të sigurt përmes bashkëpunimeve të qëndrueshme. Qasja jonë përfshin partneritete të ngushta me organizatat vendase, autoritetet dhe komunitetet e vendeve pritëse. Duke punuar me këto palë interesi, krijojmë një rrjet që jo vetëm identifikon rreziqe të mundshme, por edhe harton e zbaton strategji efektive për t'i zbutur ato. Kjo përpjekje bashkëpunuese u mundëson Vullnetarëve tanë të përqendrohen te misioni i tyre, duke ditur se ka një sistem mbështetjeje në dispozicion për ta, duke nxitur një ndjenjë qëndrueshmërie në komunitet dhe përgjegjësie të përbashkët për sigurinë.

Fuqizimi i stafi përmes ekspertizës në siguri dhe sigurim:

Trajnimi rigoroz i ofruar për anëtarët e stafit tonë qëndron në thelb të angazhimit tonë për sigurinë dhe sigurimin. Programi ynë gjithëpërfshirës e pajis stafin me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të reaguar efektivisht ndaj një larmie skenarësh sigurie dhe sigurimi. Përmes simulimeve, workshop-eve dhe edukimit të vazhduar, anëtarët e stafit tonë aftësohen në vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të mundshme. Kjo qasje proaktive jo vetëm që fuqizon aftësinë tonë për të parandaluar incidentet, por edhe përmirëson aftësitë tona reaguese në situata të paparashikuara. Siguria dhe mirëqenia e Vullnetarëve tanë mbështetet te kompetenca e stafit tonë, duke e kthyer këtë program trajnimi në një element të domosdoshëm të angazhimit tonë për të garantuar një mjedis të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit e Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi.



Trajnimet janë pjesë e qasjes proaktive të stafit për krijimin e një mjedisi të sigurt shërbimi për VKP-të.

Stafi ynë i përherëshëm gjatë vitit 2023

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi krenohet me stafin e dedikuar të përbërë nga amerikanët, shqiptarët dhe malazezët, ndër më të talentuarit e të dyja vendeve ku shërbejmë. Ekipi ka në fokus ofrimin e ndihmës për Vullnetarët tanë në mënyrë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë gjatë shërbimit. Ata janë të emocionuar për punën e tyre dhe që do të bëjnë diferencën për fëmijët, komunitetet dhe njerëzit në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ky është ekipi përgjegjës për punën e mirë që kemi bërë në Shqipëri që nga viti 1992, por edhe për menaxhimin e mundësisë së re për të shërbyer në Mal të Zi.

Agim Dyrmishi

Arben Cako

Arben Loci

Ardijan Cobaj

Ardita Qosja

Artenca Collaku

Benard Babaj

Besa Arapi

Darina Kaltani

Diana Djaloshi

Dorontinë Berishaj

Elsona Cupi

Florian Muhaj

Gentian Leka

Geri Martiri

Ilir Memlikaj

Ilir Ziu

Iris Dollia

Ivana Delibasic

Jeffery Warner

Jelena Tripkovic

Julian Pando

Luka Bobicic

Lumturi Piciri

Marie

Aughenbaugh

Marjeta Zavalani

Megan Wilson

Milena Pejovic

Mira Luca

Mirela Tahiraj

Monika Mukja

Qazim Hoxha

Rikela Fusha

Sara Gaçe

Suida Shima

Ylli Cupi



Anëtarët e stafit në një event për zhvillimin e ekipit gjatë vitit 2023

Një shërbim i rikonceptuar dhe novator - Organizata partnere

Organizata jo qeveritare (OJQ)

- Agro-Puka
- Fondacioni i Zhvillimit të Kapaciteteve Vendore Shqiptare
- Këshillat Amerikanë
- Qendra ARKA-Shkodër
- CSDC Durrës
- Darien Book Aid
- Shoqata e Mësuesve të Gjuhës Angleze
- Unioni i Anglishtfolësve
- Fondacioni Food Bank Albania
- Friends of Albania
- Junior Achievement Shqipëri
- Mary Ward Loreto
- Fëmijët janë e ardhmja (FJA)
- Qendra Konsumatori Shqiptar (QKSH)
- New Bridges
- Qendra "Marrëdhënie"
- Agjencia e Zhvillimit Rajonal-Korçë
- Sidi Education
- Terre des Hommes
- Touristic Dibra
- Water Charity
- World Association of Girl Guides and Girl Scouts
- World Connect
- World Vision
- Qendra rinore —Vlorë
- Youth in Free Enterprise

Bashkitë

Shprehim vlerësimet tona për bashkitë partnere në Shqipëri

Organizata qeveritare dhe të pavarura

- Ministria e Arsimit dhe Sporteve
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit e Malit të Zi
- ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar - Shqipëri)
- DPAP(Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - Shqipëri)
- Drejtoria Arsimore e Rajonit të Veriut, Shqipëri
- Projekti "Shëndet për të Gjithë" - Shqipëri
- Shoqata e Paraplegikëve e Malit të Zi
- Instituti Shqiptar i Shëndetit Publik
- Forum MNE
- Shoqata e Mësuesve të Gjuhës Angleze e Malit të Zi
- Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi
- Ministria e Punëve të Brendshme e Malit të Zi
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) në Shqipëri dhe Mal të Zi
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
- Ambasadat e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri dhe Mal të Zi dhe Këndet Amerikane
- Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Gjuhës Angleze
- Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjuhës Angleze

Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe Zyrat e Arsimit

- | | | |
|----------|-----------|----------|
| • Berat | • Lezhë | • Përmet |
| • Durrës | • Lushnjë | |
| • Fier | • Mat | |
| • Korçë | • Shkodër | |
| • Kukës | • Skrapar | |

Një shërbim i rikonceptuar dhe novator - Organizata partnere

Organizata jo qeveritare (OJQ)

- Qendra Epoka e Re
- Qendra Mjedisore Për Studime dhe Zbatime-
- SOS Fshatrat e Fëmijëve - Tiranë dhe Shkodër
- Tjetër Vizion-
- Open Gov Hub Albania
- Shoqata e Zhvillimit të Lidershipit për Ballkanin
- YEC
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”
- Agjencia e Zhvillimit Rajonal -
- Argonaut - Tepelenë
- Përfshirja Sociale për Zhvillim
- Qendra “Lëvizja Rinore”
- Qendra Internazionale për Solidaritet
- Youth of Ura
- Qendra Komunitare Nishtulla
- Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare
- “Me Komunitetin për Ndryshim”
- Porta Rome për Integrim



Korpusi i Paqes në Shqipëri
Rr. Besnik Sykja, Godina 2
Hyrja 1, Kutia Postare 8180
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 42 365 5033

Korpusi i Paqes në Mal të Zi
Vaka Đurovića bb, Podgoricë, Mali i
Zi

Tel: +382 (0) 20674509

Email: AL-information@peacecorps.gov

Faqja e internetit:

peacecorps.gov/albania/
peacecorps.gov/montenegro/

Facebook:

facebook.com/albania.peacecorps
facebook.com/peacecorpsinmontenegro

Instagram:

na gjeni duke kërkuar: [@peacecorpsalbania](https://www.instagram.com/peacecorpsalbania)

na gjeni duke kërkuar:
[@peacecorpinmontenegro](https://www.instagram.com/peacecorpinmontenegro)